



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 154

Tiranë – E mërkurë, 2 shtator 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 26.8.2015	Për licencimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjit profesional, “Kolegji Profesional i Tiranës”, Tiranë..... 11115
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 26.8.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 11115
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 26.8.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 306, datë 24.5.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar..... 11116
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 26.8.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 827, datë 11.6.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen, pranë universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) dhe për mënyrën e funksionimit të tij në periudhën kalimtare”, të ndryshuar..... 11116
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 26.8.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar..... 11117
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 26.8.2015	Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor..... 11118
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 26.8.2015	Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë në bordin e mjeteve lundruese të peshkimit”..... 11123

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 26.8.2015	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Agron Bala.....	11132
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 26.8.2015	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Alban Zeneli.....	11133
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 26.8.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës hyrëse të Doganës Morinë.....	11133
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 715, datë 26.8.2015	Për krijimin e skemës “Voucher”.....	11135
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 716, datë 26.8.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Lorenzo” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Depo nr. 1, Depo nr. 2 dhe Depo nr. 3, të Agjencisë së Rezervave të Shtetit Plasë, Korçë”, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.....	11136

**VENDIM****Nr. 699, datë 26.8.2015**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT
TË ARSIMIT TË LARTË, PRIVAT, ME
STATUSIN E KOLEGJIT PROFESIONAL,
“KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS”,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pikat 4, 7, 43, 44, 44/1 dhe 45, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjit profesional, “Kolegji Profesional i Tiranës”, në emër të shoqërisë “KPT”, sh.p.k., i cili do të ushtrojë veprimtarinë e tij në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji Profesional i Tiranës do të organizohet në tri departamente:

- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;
- Departamenti i Elektro-Mekanikës;
- Departamenti i Ndërtimit dhe Sistemeve të Aplikuara.

3. Kolegji Profesional i Tiranës do të ofrojë programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në këto drejtime:

- Teknologji informacioni dhe komunikimi;
- Elektronikë;
- *Database* dhe *web design*;
- Elektro-mekanikë;
- Teknologji automjetesh;
- Mekatronikë;
- Teknologji ajrimi dhe kondicionimi;
- Gjeodezi;
- Teknologji ndërtimi.

4. Programet e studimit jouniversitare, profesionale, të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, realizohen me 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve do të jetë 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tyre do të lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer.

5. Kolegji Profesional i Tiranës do të organizohet dhe do të ushtrojë veprimtarinë e tij sipas ligjit për arsimin e lartë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

6. Kolegji Profesional i Tiranës duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Inspektorati Shtetëror për Arsimin për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe kolegji profesional, privat, “Kolegji Profesional i Tiranës” për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 701, datë 26.8.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1, 14, pika 1, 18, pikat 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “A”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. ALIASKHAB 2; ALIBULATOVICH 3; KEBEKOV 4.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 704, datë 26.8.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 306, DATË 24.5.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË DO TË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 6, të nenit 7, të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 306, datë 24.5.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim emërtesa “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohet me “Ministria përgjegjëse për sportet”.

2. Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Titulli i aneksit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Lista e materialeve dhe e pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar”.

b) Kudo ku përmendet emërtesa “Federata shqiptare” shtohen fjalët “... dhe klubet sportive shqiptare ...”.

c) Në fund të çdo kapitulli shtohet sipas rendit numerik respektiv togfjalëshi “Autobus (copë 1)”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 706, datë 26.8.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 827, DATË 11.6.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE TË INTEGRUARA ME PRAKTIKËN (FASTIP) DHE PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË TIJ NË PERIUDHËN KALIMTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 9, 41 dhe 42, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit nr. 827, datë 11.6.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, afati nga “... 7 vjet (2008 – 2015) ...” bëhet “... 8 vjet (2008 - 2016), ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



VENDIM

Nr. 707, datë 26.8.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 107, DATË 10.2.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
BOTIMIN, SHYTPJEN, SHPËRNDARJEN
DHE SHITJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 6.1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP-së), sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

ç) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti.”

2. Pas pikës 6.8 shtohen pikat 6.9, 6.10 dhe 6.11, me këtë përmbajtje:

“6.9. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore të arsimit bazë mbulohet në masën 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

a) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktimat të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.

Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit në përputhje me vendimin

nr. 582, datë 27.7.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit”.

b) Për individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit /vuajtjes së dënimit.

c) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti.

ç) Për fëmijët e policëve të rënë në detyrë.

d) Për çdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.

6.10. Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë, duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6.11. Për tekstet shkollore të fëmijëve nga klasa I deri IX, të cilët janë përfitues në institucionet e përkuqjesjes sociale rezidenciale publike, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura dhe të dorëzojnë në drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.”

II. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Drejtësisë, ministri i Financave, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 708, datë 26.8.2015

**PËR LLOJET, PERIODICITETIN DHE
MËNYRËN E RAPORTIMIT TË TË
DHËNAVE STATISTIKORE PËR
AFTËSINË E KUFIZUAR NGA
STRUKTURAT SHETËRORE
PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR
DHE VENDOR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas fushave ku operojnë, me qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.

2. Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave nga institucionet, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave, për garantimin e konfidencialitetit dhe për respektimin e jetës private të tyre. Këto të dhëna janë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

3. Institucionet e pavarura, bazuar në funksionimin e tyre, i dërgojnë, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, krijuar pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar.

4. Institucionet e administratës shtetërore, bazuar në funksionimin e tyre, i dërgojnë, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Bashkitë u dërgojnë, periodikisht, nëpunësve që mbulojnë çështjet e aftësisë së kufizuar, në qarkun përkatës, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Qarku përpunon të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, të përcjella nga bashkitë, pjesë e tij, dhe ia përcjell ato, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

7. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, përpunon të dhënat e grumbulluara, nëpërmjet sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

8. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, monitoron përditësimin progresiv të të dhënave, sipas treguesve të përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit. Të dhënat janë pjesë e raportit që sekretariati teknik dërgon te të gjithë anëtarët e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.

9. Sekretariati teknik për aftësinë e kufizuar i dërgon të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara, sipas pikave 3–8, të këtij vendimi, në Institutin e Statistikave (INSTAT).

10. Instituti i Statistikave bën anketime të dedikuara për çështjet e aftësisë së kufizuar. Rezultatet e anketimeve i bën publike dhe informon, zyrtarisht, ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

11. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



ANEKSI 1
TREGUESIT PËR AFTËSINË E KUFIZUAR SIPAS FUSHAVE

Nr.	Lloji i statistikave	Institucioni përgjegjës	Periodiciteti
I	Edukimi		
1	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin parashkollor. Të ndarë sipas: <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nevojës për mbështetje (nëse duan asistent shtesë). 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
2	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin e detyruar. Të ndarë sipas: <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nevojës për mbështetje (nëse duan asistent shtesë). 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
3	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin e mesëm. Të ndarë sipas: <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - tipit të shkollës (e përgjithshme/profesionale/të veçanta). 	Ministria e Arsimit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
4	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin e lartë. Të ndarë sipas: <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nivelit (bachelor/master). 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
5	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë ndërprerë shkollën. Të ndarë sipas: <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - shkakut të ndërprerjes. 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
6	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfundojnë shkollën fillore. Të ndarë sipas: <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore



	<ul style="list-style-type: none"> - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale). 		
7	<p>Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfundojnë 9-vjeçaren.</p> <p>Të ndarë sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale). 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
8	<p>Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfundojnë shkollën e mesme.</p> <p>Të ndarë sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - tipit të shkollës (e përgjithshme/profesionale/të veçanta). 	Ministria e Arsimit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	vjetore
9	<p>Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të diplomuar.</p> <p>Të ndarë sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nivelit (bachelor/master). 	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
10	<p>Numri i mësuesve që kanë marrë kualifikime për aftësinë e kufizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numër fizik; - përqindje/kundrejt totalit. 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
11	<p>Numri i shkollave që kanë psikologë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kohë të plotë; - kohë të pjesshme. 	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
12	<p>Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që shoqërohen nga prindërit gjatë kohës së mësimit</p>	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
13	<p>Numri i shkollave 9-vjeçare/të mesme/profesionale të aksesueshme për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fëmijë në karrige me rrota; - fëmijë të verbër. 	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
14	<p>Numri i nxënësve që nuk dëgjojnë që frekuentojnë shkollën e mesme</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgjithshme; - profesionale; - sipas gjinisë. 	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
15	<p>Numri i aktiviteteve sportive ku përfshihen PAK</p>	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
16	<p>Numri i institucioneve sportive të aksesueshme për PAK-un</p>	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore



II	Shëndetësia		
17	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të konstatuar në lindje. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë	Vjetore
18	Numri i fëmijëve autikë të diagnostikuar nga institucionet shëndetësore. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë	Vjetore
19	Numri i fëmijëve autikë që marrin trajtim në institucione të specializuara. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë Bashkia	Vjetore
20	Numri i personave me aftësi të kufizuara mendore që marrin trajtim në institucione shëndetësore. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë	Vjetore
21	Numri i qendrave shëndetësore parësore të aksesueshme (urbane/rurale)	Ministria e Shëndetësisë Bashkia	Vjetore
22	Numri i spitaleve të aksesueshme	Ministria e Shëndetësisë Bashkia	Vjetore
III	Drejtësia		
23	Numri i PAK-ut që përfitojnë nga ndihma ligjore falas. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Drejtësisë	Vjetore
24	Numri i PAK që aplikojnë për të përfituar nga ndihma ligjore falas. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Drejtësisë	Vjetore
25	Numri i institucioneve të drejtësisë të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Drejtësisë	Vjetore
26	Numri i proceseve gjyqësore ku janë të përfshirë PAK.	Ministria e Drejtësisë	Vjetore



	Të ndarë sipas: - paditës; - i paditur.		
IV	Strehimi/zhvillimi urban/infrastruktura/transporti		
27	Numri i banesave të aksesueshme, të ndërtuara nga EKB-ja	Ministria e Zhvillimit Urban Enti Kombëtar i Banesave	Vjetore
28	Numri i aplikimeve të bëra nga PAK-u për procedurë legalizimi	ALUIZNI	Vjetore
29	Numri i PAK-ut, përfitues nga ligji për legalizimin	ALUIZNI	Vjetore
30	Numri i stacioneve dhe i mjeteve të transportit qytetës të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Bashkia	Vjetore
V	Punësimi		
31	Numri i PAK-ut të regjistruar si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punësimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
32	Numri PAK-ut të punësuar nga zyrat e punësimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
33	Numri i PAK-ut të punësuar në subjekte private, ndarë sipas gjinisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
34	Numri i PAK-ut të punësuar nga programi specifik për nxitjen e punësimit të PAK-ut, ndarë sipas gjinisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
35	Fondi i shpenzuar për punësimin e PAK-ut, nga programi specifik për nxitjen e punësimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
36	Numri i zyrave të punësimit të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
37	Numri i qendrave të arsimit profesional të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
38	Numri i PAK-ut që ndjekin kurse profesionale. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - llojit të kursit profesional.	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
39	Numri i PAK-ut që punësohen pas përfundimit të kurseve profesionale	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore



VI	Kultura		
40	Numri i institucioneve dhe i objekteve të kulturës të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Kulturës Bashkia	Vjetore
41	Numri aktiviteteve kulturore ku janë të përfshirë PAK	Ministria e Kulturës Bashkia	Vjetore
42	Numri i artistëve me aftësi të kufizuara. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë.	Ministria e Kulturës Bashkia	Vjetore

VENDIM

Nr. 709, datë 26.8.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KËRKESAT MINIMALE TË
SIGURISË DHE TË SHËNDETIT NË
PUNË NË BORDIN E MJETEVE
LUNDRUESE TË PESHKIMIT”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 142–147 e 401, shkronja “a”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 42, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë në bordin e mjeteve lundruese të peshkimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të gjitha subjektet me personalitet juridik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 2 (dy) vite pas botimit.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

¹Ky vendim i Këshillit të Ministrave përafrohet plotësisht Direktivën e Këshillit 93/103 /KE, të datës 23 nëntor 1993, në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë në bordin e mjeteve lundruese të peshkimit (Direktiva e trembëdhjetë individuale në kuptim të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE).

RREGULLORE

**PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË
DHE TË SHËNDETIT NË PUNË NË
BORDIN E MJETEVE LUNDRUESE TË
PESHKIMIT
2015**

**SEKSIONI I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME**

**Neni 1
Objekti**

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për punëmarrësit që punojnë në bordin e mjeteve lundruese të peshkimit që mbajnë flamurin shqiptar.

2. Dispozitat e ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, janë plotësisht të zbatueshme në fushën e përmendur në pikën 1, pa cenuar dispozitat më shtrënguese dhe/ose specifike të kësaj rregulloreje.

**Neni 2
Përkufizime**

1. Për efekt të kësaj rregulloreje, termat e mposhtëm kanë këto kuptime:

“Mjet lundrues”, çfarëdolloj mjeti lundrues peshkimi, i ri apo ekzistues;

“Mjet lundrues peshkimi”, çdo mjet lundrues i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese, të krijuar dhe të mbajtur në Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit (RAP), të drejtorisë që mbulon peshkimin, në zbatim të legjislacionit në fuqi, që lundron me flamurin shqiptar, përdoret apo synohet të përdoret për shfrytëzimin e burimeve të peshkimit për qëllime tregtare, përfshirë mjetet lundruese mbështetëse, mjetet lundruese përpunuese të peshkut, mjetet lundruese të



përfshira në transbordim dhe mjetet lundruese transportuese, të pajisura me mjete për transportimin e produkteve të peshkut;

“Mjet i ri lundrues”, mjet lundrues peshkimi me gjatësi ndërmjet pinguleve prej 15 metrash apo më shumë dhe për të cilin, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje apo pas saj:

i) ka një kontratë për ndërtimin apo për kryerjen e ndryshimeve madhore;

ii) kjo kontratë daton përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, e cila realizohet tre apo më shumë vjet pas kësaj date;

iii) në mungesë të një kontrate ndërtimi:

- është shtruar kili;

- fillon ndërtimi i identifikueshëm i një mjeti lundrues të veçantë;

- montimi ka filluar, duke përfshirë të paktën 50 tonë ose 1% të masës së vlerësuar të të gjithë materialit strukturor, cilado që është më e vogël.

“Mjet lundrues ekzistues”, çdo mjet lundrues peshkimi me një gjatësi ndërmjet pinguleve prej 18 metrash ose më shumë, i cili nuk është një mjet i ri lundrues peshkimi;

“Punëmarrës”, çdo person, sipas përkufizimit në ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, që kryen një punë në bordin e mjeteve lundruese të peshkimit, përfshirë personat që trajnohen dhe praktikantët, por duke përjashtuar personelin mbështetës në tokë, që kryen punë në bordin e një mjeti lundrues në mol, si dhe pilotët e portit;

“Pronar” ose “Pronar i mjetit lundrues”, çdo person, sipas përkufizimit në ligjin nr. 9254, datë 15.7.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kushtet e regjistrimit të anijeve””;

“Përdorues i mjetit lundrues”, pronari ose çdo person tjetër, si menaxheri apo çarteruesi bareboat, i cili ka marrë përgjegjësinë për operimin e mjetit lundrues nga pronari i mjetit lundrues, ka rënë dakord për marrjen e kësaj përgjegjësie, si dhe ka marrë përsipër të gjitha detyrimet e kësaj rregulloreje;

“Kapiteni”, çdo person që ka komandën e mjetit lundrues dhe mban përgjegjësi, sipas përcaktimeve të nenit 138, pikat 1, 2, 3 e 4, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Për Kodin Detar në Republikën e Shqipërisë”;

“Inspektim”, vizita e trupave inspektuese kompetente në bord, për të kontrolluar kërkesat minimale për sigurinë dhe për shëndetin në punë të punëmarrësve, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar.

SEKSIONI II DETYRAT E PËRDORUESVE TË MJETEVE LUNDRUESE TË PESHKIMIT DHE KAPITENËVE TË TYRE

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Për efekt të sigurisë dhe të shëndetit të personave në punë, përdoruesi i mjetit lundrues:

a) siguron që mjeti lundrues të përdoret pa rrezikuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, në veçanti në kushte meteorologjike të parashikueshme, pa cenuar përgjegjësinë e kapitenit;

b) merr parasysh risqet e mundshme për punëmarrësit, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar;

c) siguron hartimin e një raporti të detajuar për çdo ngjarje në det, e cila ndikon ose mund të ndikojë mbi sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në bord, raport i cili u dërgohet autoriteteve kompetente për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe merr masa për dokumentimin e detajuar me kujdes në ditarin e anijes.

Raporti nënshkruhet nga kapiteni, pronari, përdoruesi apo agjenti dhe përmban emrin e anijes, numrin e IMO-së, portin e regjistrimit, vendin ku ndodhet anija, rrethanat në të cilat ka ndodhur dëmi apo lëndimi dhe shkaqet e mundshme të tij.

Neni 4

Mjetet e reja lundruese të peshkimit

Përdoruesi siguron që mjeti i ri lundrues të jetë në përputhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë, të përcaktuara në shtojcën I, të kësaj rregulloreje.



Neni 5

Mjetet lundruese ekzistuese të peshkimit

Përdoruesi siguron përshtatjen e mjetit lundrues ekzistues të peshkimit për plotësimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe të shëndetit, sipas shtojcës I të kësaj rregulloreje, brenda një afati kohor prej jo më shumë se 24 muaj nga data e miratimit, me përjashtim të kërkesave që zbatohen vetëm për mjetet e reja lundruese të peshkimit.

Neni 6

Riparimet kapitale ose shndërrimet dhe ndryshimet madhore

Në rastet kur mjeti lundrues u nënshtrohet riparimeve kapitale, shndërrimeve ose ndryshimeve madhore, këto duhet të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse minimale, të përcaktuara në shtojcën I të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Pajisjet dhe mirëmbajtja

1. Pa cenuar përgjegjësinë e kapitenit, përdoruesi i mjetit lundrues, për të ruajtur sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve:

a) siguron që mjeti lundrues dhe pjesët e pajisjet e tij, veçanërisht, ato të përmendura në shtojcën I, të kësaj rregulloreje, të mirëmbahen teknikisht dhe që çdo defekt i zbuluar, që mund të ndikojë mbi sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, të riparohet sa më shpejt të jetë e mundur;

b) merr masa për të siguruar që mjeti lundrues dhe të gjitha pjesët dhe pajisjet të pastrohen rregullisht, për të ruajtur standardin e përshtatshëm të higjienës;

c) mban në bordin e mjetit lundrues një numër të mjaftueshëm të pajisjeve të përshtatshme për shpëtimin e jetës dhe të mbijetesës, në gjendje të mirë pune;

ç) përmbush kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit, lidhur me mjetet e shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës, që ndodhen në shtojcën II të kësaj rregulloreje;

d) merr parasysh kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit, në lidhje me pajisjet e shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës, të parashikuara në shtojcën III;

dh) përmbush kërkesat e parashikuara në shtojcën III, të kësaj rregulloreje, lidhur me

pajisjet mbrojtëse individuale që duhet të jenë në bord, pa cenuar dispozitat e vendimit nr. 563, datë 3.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale”.

2. Përdoruesi i mjetit lundrues, për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, i siguron kapitenit mjetet e nevojshme për t’i dhënë mundësi atij që të përmbushë detyrimet që i ngarkohen nga dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 8

Informimi i punëmarrësve

1. Në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, kapiteni ose personi i autorizuar prej tij informon me shkrim dhe në mënyrë verbale punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre për të gjitha masat që janë marrë tashmë dhe do të merren për sigurinë dhe shëndetin në bordin e mjetit lundrues.

2. Informacioni i ofruar, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, duhet të jetë i kuptueshëm për punëmarrësit.

Neni 9

Formimi i punëmarrësve

1. Në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, përdoruesi i mjetit lundrues u siguron punëmarrësve formim të përshtatshëm, veçanërisht, në formën e udhëzimeve të sakta, të kuptueshme dhe në një gjuhë që ata e kuptojnë, lidhur me sigurinë dhe shëndetin në bordin e mjeteve lundruese dhe, veçanërisht, për parandalimin e aksidenteve.

2. Formimi, i përmendur në pikën 1, përfshin, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen ndaj zjarrit, shuarjen e zjarrit, përdorimin e pajisjeve të shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës dhe, për punonjësit përkatës, përdorimin e pajimeve të peshkimit dhe të pajisjeve tërheqëse dhe përdorimin e llojeve të ndryshme të shenjave, përfshirë sinjalet me duar.

3. Kurset e formimit përditësohen kur kjo kërkohet nga ndryshimet e veprimtarive në bord.



Neni 10

Formimi i veçantë i personave që mund të drejtojnë mjetin lundrues

Në zbatim të nenit 145, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Për Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përdoruesi i mjetit lundrues i siguron çdo personi, i cili mund të drejtojë mjetin e lundrimit, formim të veçantë, për:

- a) parandalimin e sëmundjeve profesionale dhe aksidenteve në bord, si dhe masat që duhet të ndërmerren në rast të një aksidenti;
- b) stabilitetin dhe mirëmbajtjen e mjetit lundrues në të gjitha kushtet e parashikueshme të ngarkimit dhe gjatë operacioneve të peshkimit;
- c) lundrimin dhe komunikimin me radio, përfshirë edhe procedurat.

Neni 11

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në diskutimet për çështjet e mbuluara nga kjo rregullore kryhet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar.

Neni 12

Mbikëqyrja shëndetësore dhe ekzaminimet mjekësore

1. Punëdhënësi siguron mbikëqyrjen shëndetësore për të gjithë punëmarrësit që punojnë në bordin e një mjeti lundrues peshkimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikat përkatëse për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore.

2. Çdo punëmarrës që punon në bordin e një mjeti lundrues peshkimi duhet të jetë i pajisur me certifikatë të vlefshme mjekësore, e cila dëshmon aftësinë e tij shëndetësore për të kryer detyrat e tij. Kjo certifikatë lëshohet nga organi kompetent për mbikëqyrjen shëndetësore dhe ekzaminimet shëndetësore. Formatit dhe përmbajtja e certifikatës shëndetësore për detarët duhet të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të legjislacionit në fuqi.

3. Certifikata mjekësore është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se dy vjet nga data e lëshimit të saj, përveç rasteve kur punëmarrësi

është nën moshën 21 vjeç, rast në të cilin periudha maksimale e vlefshmërisë është jo më shumë se një vit.

4. Punëdhënësi i siguron punëmarrësit, për të cilin vlerësimi i riskut tregon një risk për shëndetin e tij, mbikëqyrje shëndetësore, sipas nivelit të riskut, llojit dhe shkallës së dëmimit.

5. Në raste urgjente, organi kompetent për lëshimin e certifikatës mjekësore mund të lejojë që një punëmarrës të punojë në një mjet lundrues peshkimi për një periudhë kohe të kufizuar dhe të specifikuar, derisa të mund të merret një certifikatë mjekësore, me kusht që punëmarrësi të zotërojë një certifikatë mjekësore që ka skaduar së fundmi.

6. Punëmarrësve që u është refuzuar certifikata ose kanë pasur një kufizim të vendosur mbi aftësinë e tyre për të punuar, u jepet mundësia për ankim, në përputhje me nenin 143, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Për Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë”.

7. Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore, përfshirë konkluzionet mbi aftësinë për të punuar për çdo punëmarrës, dokumentohen dhe përditësohen nga mjeku i punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen shëndetësore në punë dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, në një mënyrë që lejon konsultimin e tyre të mëvonshëm. Punëmarrësi, me kërkesë të tij/saj, ka akses të të dhënave kartelës së tij/saj të shëndetit në punë. Kopjet e kartelave shëndetësore në punë u vihen në dispozicion autoriteteve kompetente, sipas kërkesës, duke ruajtur çdo konfidencialitet.

SEKSIONI III

MEKANIZMI I KONTROLLIT, INSPEKTIMI

Neni 13

1. Mjetet lundruese të peshkimit janë subjekt i inspektimit nga trupat inspektuese, sipas përcaktimeve të neneve 39 dhe 40, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

2. Inspektimet në lidhje me respektimin e kësaj rregulloreje mund të kryhen edhe në det.

Neni 14

1. Nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, pas inspektimit, sipas nenit 14, të kësaj rregulloreje,



autoriteti kompetent mund të kërkojë bllokimin e mjetit lundrues të peshkimit që nuk respekton dispozitat e neneve 4 deri 7, të kësaj rregulloreje.

2. Nëse trupat inspektuese konstatojnë shkelje të kërkesave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në punë, lëshohet një akt inspektimi dhe i kërkohet me shkrim kapitanerisë së portit ndalimi i daljes së mjetit lundrues të peshkimit në det, deri në plotësimin e detyrave të caktuara në aktin e inspektimit.

3. Gjatë ushtrimit të inspektimit, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, bëhet çdo përpjekje për të shmangur ndalimin e paligjshëm apo vonesën e mjetit lundrues të peshkimit.

4. Në rast të ndalimit apo vonesës së paligjshme, përdoruesi i mjetit lundrues ka të drejtë për kompensim për çdo humbje apo dëm të pësuar, në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 15

Shfrytëzuesi i mjetit lundrues ose përfaqësuesi i tij në Shqipëri ka të drejtën e ankimit administrativ kundër vendimit të ndalimit apo të vendosjes së gjobës administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI IV DISPOZITA TË TJERA

Neni 16

Për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe në bazë të udhëzimeve ndërkombëtare, ministritë përgjegjëse për transportin detar, për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe për shëndetësinë, hartojnë manuale shpjeguese për masa të veçanta mbrojtëse dhe parandaluese në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në mjetet lundruese të peshkimit.

Neni 17

Sanksionet

Në rast të shkeljes së dispozitave të përfshira në këtë rregullore zbatohen sanksionet e përcaktuara në nenin 43, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar.

SHTOJCA I KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE TË SHËNDETTIT PËR MJETET LUNDRUESE

Shënim paraprak

Detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen sa herë kjo diktohet nga karakteristikat e vendit të punës, veprimtaria, rrethanat ose një risk i veçantë në bordin e një mjeti lundrues të peshkimit.

Për mjetet lundruese ekzistuese të peshkimit detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen për aq sa lejojnë karakteristikat strukturore të tyre, sa herë që kërkohet nga tiparet e vendit të punës, aktiviteti, rrethanat ose një risk në bordin e një mjeti lundrues ekzistues të peshkimit.

1. Aftësia lundruese dhe qëndrueshmëria në det

1.1. Mjeti lundrues duhet të mbahet në gjendje të përshtatshme për të lundruar në det dhe të jetë i pajisur siç duhet me mjete, në përputhje me qëllimin dhe përdorimin e tij.

1.2. Informacioni lidhur me qëndrueshmërinë e mjetit lundrues duhet të jetë i disponueshëm në bord dhe të jetë i aksesueshëm për personin në shërbimin roje.

Për mjetet lundruese ekzistuese të peshkimit, të dhënat për qëndrueshmërinë e mjetit lundrues, kur ato ekzistojnë, duhet të jenë të disponueshme në bord dhe duhet të jenë të arritshme për personin në shërbimin roje.

Gjithashtu, duhet të zbatohen edhe dispozitat e pikës 2, të nenit 211, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Për Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

1.3. Të gjitha mjetet lundruese duhet të jenë mjaftueshëm të qëndrueshme, kur janë të padëmtuara, në kushtet e shërbimit për të cilat ato janë destinuar. Kapiteni merr masa parandaluese, të nevojshme për të ruajtur një qëndrueshmëri të mjaftueshme të mjetit lundrues. Udhëzimet e dhëna lidhur me qëndrueshmërinë e mjetit lundrues duhet të respektohen me rigorozitet.

2. Instalimet mekanike dhe elektrike

2.1. Instalimet elektrike projektohen dhe ndërtohen në mënyrë që të mos paraqesin ndonjë rrezik dhe sigurojnë:



- mbrojtje për ekuipazhin dhe mjetin lundruer nga rreziqet elektrike;

- funksionimin e duhur të të gjitha pajisjeve të nevojshme për të mirëmbajtur anijen në kushte normale operacionale dhe jetësore, pa iu drejtuar furnizimit me energji për raste emergjente;

- funksionimin e pajisjeve elektrike thelbësore për sigurinë në të gjitha rastet e emergjencave.

2.2. Duhet të sigurohet burim i energjisë elektrike për rastet e emergjencave.

Përveç rasteve të mjeteve lundruese të hapura, ai duhet të vendoset jashtë lokalit të motorit dhe, në të gjitha rastet, duhet të mbahet në gjendje pune, në mënyrë që në rastin e një zjarri apo avarive të tjera të instalimeve kryesore elektrike, të sigurojë funksionimin e njëkohshëm për paktën tri orë të:

- sistemit të komunikimit të brendshëm, detektorëve të zjarrit dhe sinjaleve të emergjencës;

- dritave të lundrimit dhe ndriçimit të emergjencës;

- instalimit të radios;

- pompave elektrike të zjarrit për emergjencat, kur janë të pranishme.

Nëse burimi i energjisë elektrike për rastet e emergjencës është një bateri akumulatore dhe burimi kryesor i energjisë elektrike ndërpritet, bateria akumulatore duhet të lidhet automatikisht në panelin elektrik të emergjencës dhe të furnizojë me energji, për një periudhë të pandërprerë prej të paktën 3 orësh, sistemet e përmendura në paragrafin e mësipërm.

Paneli kryesor elektrik dhe paneli elektrik i emergjencës duhet, për aq sa të jetë e mundur, të instalohen në mënyrë të tillë që të mos ekspozohen njëkohësisht ndaj ujit apo zjarrit.

2.3. Panelet elektrike shënjojnë në mënyrë të qartë; kutitë e siguresave dhe mbajtëset e siguresave kontrollohen në intervale të rregullta, për të siguruar që po përdoret klasifikimi korrekt i siguresës.

2.4. Lokali i baterive ajroset në mënyrë të mjaftueshme.

2.5. Pajisjet ndihmëse elektronike për lundrimin testohen në mënyrë të shpeshtë dhe mirëmbahen siç duhet.

2.6. Të gjitha pajisjet e përdorura për ngritjen vertikale testohen dhe ekzaminohen në intervale të rregullta, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2.7. Të gjitha pjesët e mekanizmit të tërheqjes, të ngritjes vertikale dhe pajisjet e tjera të lidhura me

to, duhet të mirëmbahen në gjendje të mirë teknike dhe pune.

2.8. Në rastet kur instalohen impiantet frigoriferike dhe sisteme të ajrit të kompresuar ato duhet të mirëmbahen siç duhet dhe të ekzaminohen në intervale të rregullta.

2.9. Pajisjet e gatimit dhe ato shtëpiake që përdorin gazra të rënda duhet të përdoren vetëm në hapësira të ajrosura mirë dhe duhet pasur kujdes për të shmangur çdo akumulim të rrezikshëm të gazit.

Bombolat që përmbajnë gazra të ndezshme dhe gazra të tjera të rrezikshme duhet të shënohen në mënyrë të qartë, sa i takon përmbajtjes së tyre dhe të mbushen në kuverta të hapura.

Të gjitha valvulat, rregullatorët dhe tubat e presionit që dalin nga bombolat duhet të mbrohen nga dëmtimi.

3. Instalimi i radios

Instalimi i radios duhet të lejojë kontaktin gjatë gjithë kohës, me të paktën një stacion bregdetar ose tokësor, duke marrë në konsideratë kushtet normale për përhapjen e valëve të radios.

4. Rrugët dhe daljet e emergjencës

4.1. Rrugët dhe daljet që mund të përdoren si rrugë e dalje të emergjencës, duhet të mbahen të lira, të jenë lehtësisht të dallueshme gjatë gjithë kohës dhe të nxjerrin, sa më drejtpërdrejt të jetë e mundur, në kuvertën e hapur ose në një zonë të sigurt dhe që atje në mjetin e mbijetesës, në mënyrë që punëmarrësit të mund të evakohen nga vendet e tyre individuale të punës ose zonat ku jetojnë me shpejtësi dhe në mënyrë sa më të sigurt të jetë e mundur.

4.2. Numri, vendndodhja dhe përmasat e rrugëve dhe daljeve që mund të përdoren si rrugë e dalje të emergjencës, varen nga përdorimi, pajisjet dhe përmasat e vendeve të punës dhe zonave të jetesës dhe nga numri maksimal potencial i personave të pranishëm.

Daljet që mund të përdoren si dalje të emergjencës dhe të cilat janë të mbyllura, duhet të jenë lehtësisht të operueshme në çdo situatë emergjence nga çdo punëmarrës ose nga skuadrat e shpëtimit.

4.3. Dyert e emergjencës dhe dalje të tjera të emergjencës duhet të jenë mjaftueshëm të qëndrueshme ndaj motit dhe të papëshkrueshme nga uji, për vendndodhjen dhe funksionin e tyre të veçantë.



Dyert dhe daljet e tjera të emergjencës duhet të jenë të qëndrueshme ndaj zjarrit, si paretet ndarëse.

Ky detyrim zbatohet vetëm për mjetet e reja lundruese të peshkimit.

4.4. Rugët dhe daljet e emergjencës duhet të tregohen me shenja, në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 1012, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për sinjalistikën në kantier dhe vendin e punës”.

Shenja të tilla duhet të vendosen në pika të përshtatshme dhe t’i rezistojnë kohës.

4.5. Rugët dhe hapësirat e largimit, si dhe daljet e emergjencës që kërkojnë ndriçim, duhet të pajisjen me ndriçim, për raste emergjencash, me intensitet të mjaftueshëm, në rast të një avarie të ndriçimit.

5. Zbulimi dhe shuarja e zjarrit

5.1. Në varësi të përmasave dhe të përdorimit të mjetit lundrues, pajisjeve që ai përmban, vetive fizike dhe kimike të substancave të pranishme dhe numrin maksimal, potencial, të personave të pranishëm në bord, mjediset e jetesës dhe vendet e mbyllura të punës, përfshirë lokalitë e motorit dhe vendin ku mbahet peshku, nëse është e nevojshme, duhet të pajisen me mjete të përshtatshme kundër zjarrit dhe, sipas nevojës, me detektorë të zjarrit dhe sisteme të alarmit.

5.2. Pajisjet e fikjes së zjarrit duhet të mbahen gjithmonë në vendin e tyre të duhur, të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe të jenë në dispozicion për përdorim të menjëhershëm.

Punëmarrësit duhet të jenë në dijeni të vendndodhjes së pajisjeve kundër zjarrit, mënyrën se si ato funksionojnë dhe si duhet të përdoren.

Prania e mjeteve të shuarjes së zjarrit dhe pajisjeve të tjera portative kundër zjarrit duhet të kontrollohet gjithmonë, përpara se mjeti lundrues të nis.

5.3. Pajisjet kundër zjarrit, të operuara manualisht, duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme e të thjeshta për t’u përdorur dhe duhet të tregohen nëpërmjet shenjave, në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 1012, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për sinjalistikën në kantier dhe vendin e punës”.

Shenja të tilla duhet të vendosen në pikat e duhura dhe t’i rezistojnë kushteve atmosferike.

5.4. Sistemet e zbulimit të zjarrit dhe sistemet e alarmit duhet të testohen rregullisht dhe të mirëmbahen siç duhet.

5.5. Stërviçet për shuarjen e zjarrit duhet të kryhen në intervale të rregullta.

6. Ajrimi i vendeve të mbyllura të punës

Sigurohet ajër i freskët dhe i mjaftueshëm në vendet e mbyllura të punës, duke pasur parasysh metodat e përdorura të punës dhe kërkesat fizike për punëmarrësit.

Në rastet kur përdoret një sistem ajrimi mekanik, ai duhet të mirëmbahet në kushte të mira.

7. Temperatura e zonave të punës

7.1 Temperatura në zonat e punës duhet të jetë e përshtatshme për trupin e njeriut gjatë orëve të punës, duke pasur parasysh metodat e punës që përdoren dhe kërkesat fizike që u janë vendosur punëmarrësve dhe, kur këto zona ekzistojnë, kushtet reale apo potenciale të motit në zonën ku operon mjeti lundrues.

7.2. Temperatura në mjediset e jetesës, hapësirat higjieno-sanitare, dhomat e ngrënies dhe dhomat e ndihmës së parë, kur këto zona ekzistojnë, të jenë të përshtatshme për qëllimin e veçantë të këtyre mjedisëve.

8. Ndriçimi natyral dhe artificial i vendeve të punës

8.1 Vendet e punës duhet, sa më shumë të jetë e mundur, të marrin ndriçim natyral, të mjaftueshëm dhe të jenë të pajisura me ndriçim artificial të përshtatshëm për operacionet konkrete të peshkimit, pa vënë në rrezik sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve apo pa rrezikuar mjetet e tjera lundruese.

8.2. Instalimet për ndriçimin e mjedisëve të punës, shkallëve, shkallëve vertikale dhe rrugëve të kalimit duhet të vendosen në mënyrë të tillë që lloji i ndriçimit të sigurohet të mos paraqesë asnjë risk për aksidente për punëmarrësit dhe asnjë pengesë për lundrimin e mjetit lundrues.

8.3. Vendet e punës, në të cilat punëmarrësit janë të ekspozuar ndaj risqeve në mënyrë të veçantë, në rast të një avarie të ndriçimit artificial, duhet të pajisen me ndriçim për raste emergjencash, me intensitet të mjaftueshëm.

8.4. Ndriçimi për rastet e emergjencës duhet të mirëmbahet në gjendje pune dhe të testohet në intervale të rregullta.

9. Kuvartet, paretet ndarëse dhe paretet vertikale

9.1. Hapësirat që janë të aksesueshme nga punëmarrësit duhet të jenë jo të rrëshqitshme ose kundër rrëshqitjes, të jenë të pajisura me mjete



për të parandaluar rëniet dhe të mos kenë pengesa, për sa është e mundur.

9.2. Vendet e punës që përmbajnë vende individuale të punës duhet të jenë mjaftueshëm të papërshkueshme nga zëri dhe të izoluar, duke pasur parasysh llojin e detyrave të përfshira dhe aktivitetin fizik të punëmarrësve.

Për mjetet lundruese ekzistuese ky detyrim zbatohet vetëm për sa të jetë e mundur.

9.3. Sipërfaqet e kuvertave, pareteve ndarëse dhe vertikale në zonat e punës duhet të jenë të tilla që të mund të pastrohen ose të rinovohen në një standard të përshtatshëm të higjienës.

10. Dyert

10.1. Duhet të sigurohen mekanizma, në mënyrë që dyert të mund të operohen gjatë gjithë kohës nga brenda, pa pajisje të veçanta.

Dyert duhet të jenë të operueshme nga secila anë kur vendet e punës janë në përdorim.

10.2. Dyert dhe, në veçanti, dyert rrëshqitëse, kur këto duhet të përdoren, duhet të funksionojnë në mënyrë sa më të sigurt që të jetë e mundur për punëmarrësit, veçanërisht, në kushte të këqija të motit dhe të detit.

11. Rrugët e qarkullimit, zonat e rrezikut

11.1. Rrugët e kalimit, korridorët dhe hapësirat boshe, pjesa e jashtme e sallonit mbi kuvertën e sipërme dhe të gjitha rrugët e qarkullimit, në përgjithësi, duhet të pajisjen me barriera mbrojtëse, shufra për t'u kapur dhe litarë shpëtimi ose mjete të tjera të garantimit të sigurisë së punonjësve gjatë aktiviteteve në bord.

11.2. Nëse ka një risk që punonjësit mund të bien nga pjesët e hapura në kuvertë ose nga një kuvertë në një tjetër, duhet të sigurohet mbrojtje e përshtatshme, kurdoherë që është e mundur.

Për mjetet e reja lundruese të peshkimit barrierat mbrojtëse duhet të jenë, të paktën, një metër të larta.

11.3. Aksesit në instalime mbi kuvertë, për qëllime operacionesh ose mirëmbajtjeje, duhet të jetë i tillë që të garantojë sigurinë e punëmarrësve.

Për të parandaluar rëniet duhet të sigurohen barriera mbrojtëse ose pajisje të ngjashme të mbrojtjes së lartësisë, të përshtatshme.

11.4. Parapetet ose mjetet e tjera të vendosura për të parandaluar rënien e personave jashtë bordit duhet të mbahen në gjendje efikase.

Parapetet duhet të pajisen me porta zhbllokimi ose pajisje të tjera të ngjashme, për t'i dhënë mundësi ujit që të kullojë me shpejtësi.

11.5. Rampa e kështjës, pjesa e sipërme e rampës, duhet të jetë e pajisur me një portë ose mjete të tjera të sigurimit të saj, me të njëjtën lartësi sa dallgëpërthyeset apo mjetet e tjera ngjitur me të, për të mbrojtur punëmarrësit nga risku i rënies në rampë.

Kjo portë ose pajisje tjetër, duhet të hapet dhe mbyllet lehtësisht dhe duhet të hapet vetëm për të hedhur rrejtën ose për ta tërhequr atë brenda.

Për mjetet e reja lundruese të peshkimit, kjo portë apo mjete të tjera, duhet të hapet dhe të mbyllet lehtësisht, mundësisht me anë të telekomandës, dhe duhet të hapet për hedhjen e rrejtës apo për ta tërhequr atë brenda.

12. Struktura e vendeve individuale të punës

12.1. Zonat e punës duhet të mbahen të lira, të mbrohen nga deti dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të ofrojnë mbrojtje të përshtatshme për punëmarrësit kundër rënive në anije ose rënive jashtë bordit.

Zonat e manovrimit duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme, si në aspektin e lartësisë ashtu edhe në aspektin e sipërfaqes.

12.2. Nëse motorët komandohen nga lokali i motorit, ata duhet të komandohen nga një zonë e veçantë, e papërshkueshme nga zëri, e izoluar nga dhoma e motorit, në vetvete, dhe të jenë të aksesueshëm, pa kaluar përmes kësaj të fundit.

Ura e komandimit konsiderohet të jetë një zonë që plotëson kërkesat e mësipërme.

12.3. Komandat për mekanizmin e tërheqjes duhet të instalohen në një zonë aq të madhe sa t'u krijojë mundësi punëmarrësve që të punojnë lirisht.

Mekanizmi i tërheqjes duhet, gjithashtu, të ketë pajisje sigurie të përshtatshme për rastet e emergjencave, përfshirë hapësirat e ndalimit në raste emergjencash.

12.4. Drejtuesi i vinçit duhet të ketë një pamje të mjaftueshme të vinçit dhe të punëmarrësve të tjerë në punë.

Nëse vinçi kontrollohet nga ura, drejtuesi i tij duhet, gjithashtu, të ketë një pamje të qartë të punëmarrësve në punë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë mjeti tjetër të përshtatshëm.

12.5. Një sistem i sigurt i komunikimit duhet të përdoret ndërmjet urës dhe kuvertës së punës.



12.6. Duhet të ruhet një vështrim i mprehtë, gjithmonë, dhe ekuipazhi duhet të para-lajmërohet për ndonjë rrezik të afërt nga deti shumë i trazuar që afrohet gjatë operacioneve të peshkimit apo kur në kuvertë kryhen punë të tjera.

12.7. Kontakti me kavot e cimati dhe me pjesë të lëvizshme të pajisjeve duhet të minimizohet, duke instaluar pajisje mbrojtëse.

12.8. Duhet të instalohen mekanizma komandues për masat në lëvizje, veçanërisht, mbi peshkarexhat, si:

- pajisje për të bllokuar timonët e tratës;
- pajisje për të kontrolluar lëvizjen lëkundëse të pjesës fundore të rretës ku mbahen peshqit.

13. Mjediset e jetesës

13.1. Vendndodhja, struktura, papërshkueshmëria nga zhurmat, mjetet e izolimit dhe struktura e mjedisve e pajisjeve të jetesës së punëmarrësve, kur këto ekzistojnë, si dhe mjetet për akses në to, duhet të jenë të tilla që të ofrojnë mbrojtje të përshtatshme nga moti e deti, dridhja, zhurma dhe aromat e pakëndshme nga pjesë të tjera të mjetit lundrues, që kanë të ngjarë të shqetësojnë punëmarrësit gjatë periudhës së tyre të çlodhjes.

Në rastet kur projektimi, përmasat dhe/ose qëllimi i mjetit lundrues e lejon, mjediset e jetesës së punëmarrësve duhet të jenë të vendosura në mënyrë që të minimizohen efektet e lëvizjes dhe të rritjes së shpejtësisë.

Duhet të merren masat e duhura, për sa është e mundur, për të mbrojtur joduhanpirësit nga shqetësimet që shkaktohen nga pirja e duhanit.

Për mjetet ekzistuese lundruese të peshkimit, mjediset e jetesës së punëmarrësve duhet të jenë të tilla që të minimizohen zhurma, dridhja, efektet e lëvizjes e rritjes së shpejtësisë dhe erërat e pakëndshme nga pjesë të tjera të mjetit lundrues. Ndrysim i përshtatshëm duhet të jetë i instaluar në mjediset e jetesës.

13.2. Mjediset e jetesës së punëmarrësve duhet të ajrosen vazhdimisht, për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm me ajër të freskët dhe për të parandaluar kondensimin.

Në mjediset e jetesës duhet të sigurohet ndriçim i përshtatshëm, me:

- ndriçim normal, të përgjithshëm dhe të mjaftueshëm;

- ndriçim të reduktuar, të përgjithshëm, për të shmangur shqetësimin e punëmarrësve kur ata janë duke u çlodhur;

- ndriçim lokal, në secilin shtrat.

Ky detyrim zbatohet vetëm për mjetet e reja lundruese të peshkimit.

13.3. Kuzhina dhe vendi i ngrënies, kur këto ekzistojnë, duhet të kenë përmasa të mjaftueshme, të jenë të ndriçuara dhe të ajrosura mirë dhe të mund të pastrohen lehtësisht.

Të sigurohen frigoriferë ose pajisje të tjera për ruajtjen e ushqimeve në temperaturë të ulët.

Për mjetet lundruese ekzistuese të peshkimit kuzhina dhe vendi i ngrënies, kur këto ekzistojnë, duhet të kenë përmasa të mjaftueshme, të jenë të ndriçuara dhe të ajrosura mjaftueshëm dhe të jenë të lehta për t'u pastruar.

14. Mjediset dhe pajisjet sanitare

14.1 Në mjetet lundruese me mjedis jetese, dhomat e dusheve, me ujë të nxehtë dhe të ftohtë të rrjedhshëm, lavamanët e tualetet duhet të pajisjen e instalohen siç duhet dhe zonat përkatëse duhet të ajrosen mirë.

Për mjetet lundruese ekzistuese të peshkimit, në mjediset e jetesës duhet të instalohen lavamanë dhe, nëse është e mundur, një dush dhe zonat përkatëse duhet të ajrosen siç duhet.

14.2. Çdo punëmarrës duhet të ketë mundësi të përdorë një vend ku ai mund të mbajë veshjet e tij.

Ky detyrim zbatohet vetëm për mjetet e reja lundruese të peshkimit.

15. Ndhima e parë

Në të gjitha mjetet lundruese duhet të ketë pajisje të ndihmës së parë, në përputhje me kërkesat e nenit 145, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Për Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

16. Shkallë vertikale dhe shtigjet e akomodimit

Një shkallë vertikale apo shteg i akomodimit ose pajisje të tjera të ngjashme, që sigurojnë mjete të përshtatshme dhe të sigurta për ngjitjen në mjetin lundrues, duhet të jenë të disponueshme.

17. Zhurma

Duhet të merren të gjitha masat e duhura teknike për të reduktuar nivelin e zhurmës në vendet e punës dhe në mjediset e jetesës, për aq sa është e mundur, duke marrë parasysh përmasat e mjetit lundrues.



Ky detyrim zbatohet vetëm për mjetet e reja lundruese të peshkimit, duke marrë parasysh kërkesat e vendimit nr. 842, datë 3.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës””.

SHTOJCA II
KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE
TË SHËNDETTIT PËR PAJISJET E
SHPËTIMIT TË JETËS
DHE TË MBIJETESËS

Shënim paraprak

Detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen për aq sa lejojnë karakteristikat e vendit të punës, veprimtaria, rrethanat ose një risk në bordin e një mjeti lundrues.

1. Mjetet lundruese duhet të mbajnë pajisje të mjaftueshme të shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës, përfshirë mjete të përshtatshme të nxjerrjes së punëmarrësve nga uji dhe shpëtimit me radio, në veçanti një fener radio, që tregon pozicionin për raste emergjencash, me një mekanizëm lëshimi hidrostatik, duke marrë parasysh numrin e personave në bord dhe zonën në të cilën operon mjeti lundrues.

2. Të gjithë artikujt e pajisjeve të shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës duhet të mbahen në vendet e tyre të përcaktuara, të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe të jenë të disponueshëm për përdorim të menjëhershëm.

Ata duhet të kontrollohen nga punëmarrësi përpara se mjeti lundrues të largohet nga porti dhe gjatë udhëtimit në det.

3. Pajisjet e shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës duhet të inspektohen në intervale të rregullta.

4. Të gjithë punëmarrësit marrin formimin e duhur dhe udhëzime të përshtatshme lidhur me përballimin e një situatë emergjente.

5. Nëse gjatësia e mjetit lundrues është më e madhe se 45 metra ose nëse në të ndodhen pesë ose më shumë punëmarrës, duhet të sigurohet një vend grumbullimi, me udhëzime të qarta për secilin punëmarrës, që duhet të zbatohen në rast të një emergjence.

6. Grumbullimet e punëmarrësve për stërvitjen për mbijetesë, duhet të kryhen çdo muaj, në port dhe/ose në det.

Këto stërvitje duhet të sigurojnë që punëmarrësit të kenë një kuptim të plotë dhe të stërviten, lidhur me detyrat që ata duhet të kryejnë, sa i takon manipulimit dhe vënies në punë të të gjitha pajisjeve të shpëtimit të jetës dhe të mbijetesës.

Punonjësit duhet të jenë formuar lidhur me montimin dhe operimin e pajisjeve radio-portative, kur ka të tilla në bord.

SHTOJCA III
KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE
TË SHËNDETTIT NË LIDHJE ME PAJISJET
MBROJTËSE INDIVIDUALE

Shënim paraprak

Detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen sa herë kjo diktohet nga karakteristikat e vendit të punës, veprimtaria, rrethanat ose një risk në bordin e një mjeti lundrues.

1. Në rastet kur risqet për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve nuk mund të shmangen apo të kufizohen në mënyrë të mjaftueshme, nëpërmjet mjeteve kolektive ose teknike të mbrojtjes apo nëpërmjet masave, metodave ose procedurave të organizimit të punës, punëmarrësit duhet të pajisen me pajisje mbrojtëse individuale.

2. Pajisjet mbrojtëse individuale, në formën e veshjeve ose të vendosura mbi veshjen, duhet të jenë me ngjyra të ndritshme, në kontrast me mjedisin detar dhe të jenë të dukshme në mënyrë të qartë.

VENDIM

Nr. 710, datë 26.8.2015

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. AGRON BALA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe në vijim të vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Agron Bala, në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë.



2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 711, datë 26.8.2015

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. ALBAN ZENELI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe në vijim të vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Alban Zeneli, në masën 4 000 000 (katër milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 712, datë 26.8.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I RRUGËS HYRËSE TË DOGANËS MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 5, pikat 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës hyrëse të Doganës Morinë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “pemëtore” (tokë bujqësore), me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 285 436 (dyqind e tetë dhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 208 (dyqind e tetë) m², me vlerë shpronësimi 23 712 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë;

b) tokë “truall”, me sipërfaqe 1 246 (një mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) m², me vlerë shpronësimi 251 692 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë;

c) pemëtore (tokë bujqësore), me sipërfaqe 88 (tetëdhjetë e tetë) m², me vlerë shpronësimi 10 032 (dhjetë mijë e tridhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 285 436 (dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, zëri “Investime”.



5. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4, 5 dhe 7, të këtij vendimi.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e sipërfaqes së shpronësuar mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

8. Afati i përfundimit të punimeve për ndërtimin dhe realizimin e shpronësimit do të jetë sipas përcaktimeve të kontratës për realizimin e zgjerimit të rrugës hyrëse të Doganës Morinë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së sipërfaqes së shpronësuar mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE PRIVATË QË DO SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË ZGJERIMIT
TË RRUGËS HYRËSE NË DOGANËN MORINË, KUKËS

Fshati	Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m ²	Çmimi, lekë/m ²	Vlera totale, lekë	Lloji i vërtetimit
									Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Morinë	1	Rive Iljaz Duraku	2724	91/15	Arë	208	114	23,712	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	2	Xhevahire Qazim Gjuta (Duraku) (B/50%), Hazir Qazim Duraku (B/50%)	2724	92/3 (92/3/1)	Truall	459	202	92,718	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	3	Seladin Ymer Duraku, Lavdi Ymer Duraku, Sanije Ymer Gjuta, Elmije Ymer Ahmetaj, Shkurte Imer Dogjani, Zelihe Ymer Kadena, Myrvete Ymer Sinani, Ilir Hysni Duraku, Shkumbin Hysni Duraku, Arjana Hysni Peposhi, Laureta Hysni Asllanaj (Duraku), Fidaije Hysni Brahim (Duraku), Gazmir Hysni Duraku	2724	92/4 (92/4/1)	Truall	787	202	158,974	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	4	Lavdi Imer Duraku	2724	238/12	Pemëtore (tokë bujqësore)	88	114	10,032	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Shuma				1,542	167	285,436	



VENDIM

Nr. 715, datë 26.8.2015

PËR KRIJIMIN E SKEMËS “VOUCHER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e skemës “Voucher”, më poshtë “Skema”, me vlerë të përgjithshme 9 000 000 (nëntë milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 3 (tre) vjet, për periudhën 2015–2017. Skema fillon të zbatohet në vitin 2015, me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

- a) Për vitin 2015, vlera e fondit të jetë 1 000 000 (një milion) lekë;
- b) Për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 4 000 000 (katër milionë) lekë;
- c) Për vitin 2017, vlera e fondit të jetë 4 000 000 (katër milionë) lekë.

2. Skema, përveç fondeve nga buxheti i shtetit, të parashikuara në pikën 1, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

3. Skema u jep ndihmë, në formë granti të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, nëpërmjet bashkëfinancimit. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, skema mbulon 85% të kostove të pranueshme nga buxheti i shtetit, por jo më shumë se 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

4. Objektivi kryesor i Skemës është stimulimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, që operojnë në fushën e prodhimit, përfshirë agroindustrinë, si dhe prodhimin e programeve kompjuterike (software TIK), për t’u mundësuar atyre transferimin e drejtpërdrejtë të njohurive, nga ofruesit e shërbimeve, për inovacione, teknikat e marketingut, duke ofruar përvoja dhe praktika më të mira, që nuk janë aplikuar më parë

te kompania aplikuese dhe që do të ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe performancës ekonomike të saj.

5. Qëllimi i Skemës është rritja dhe zhvillimi i aftësive menaxheriale dhe teknike për krijimin e produkteve të reja, proceseve ose shërbimeve inovative, si dhe mundësimi i krijimit të një lidhjeje të vazhdueshme me ofruesit e këtyre shërbimeve.

6. Kostot e pranueshme që mund të bashkë-financohen, përfshijnë ato për:

- a) zhvillimin e produkteve të reja, përmirësimin e produkteve ekzistuese;
- b) aplikimin e proceseve të reja teknologjike apo të përmirësuara të prodhimit;
- c) përmirësimin e hallkave të logjistikës dhe sistemeve të marketingut;
- ç) zhvillimin e një modeli të ri biznesi ose strategjie zhvillimi, që premtion rritje të performancës;
- d) testimin eksperimental.

7. Nga skema “Voucher” përfitojnë ndërmarrjet që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

- a) Janë biznese të klasifikuara, si: mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar;
- b) Kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) Prodhonë produkte dhe/apo ofrojnë shërbime në Shqipëri, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit;
- ç) Janë të regjistruara në QKR dhe nuk kanë detyrime tatimore;
- d) Nuk janë në proces falimentimi ose në procedurë likuidimi;
- dh) Plotësojnë kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore;
- e) Operojnë në sektorët e prodhimit, përfshirë agroindustrinë, si dhe prodhimin e programeve kompjuterike (software TIK), që premtion rritje punësimi dhe produktiviteti;
- ë) Provojnë se operojnë në treg prej jo më pak se një viti;
- f) Nuk kanë më pak se 3 (tre) të punësuar;
- g) Janë të hapur dhe ofrojnë informacion për vlerësimin dhe impaktin e projektit, për fazën e parë, brenda 6 muajve dhe, në vazhdimësi, brenda 3 vitesh pas përfundimit të projektit.



8. Ofruesit e shërbimeve, në zbatim të kësaj Skeme, klasifikohen në:

- institucione/organizata publike/private të kërkimit shkencor/institucione të arsimit të lartë, vendëse ose të huaja, publike ose private;

- shoqëri konsulence dhe trajnimi, individë, që të jenë të regjistruar, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Koha maksimale për të siguruar konsulencën dhe transferimin e njohurive të jetë 45 ditë.

10. Për efekt të zbatimit të kësaj Skeme, Ministria e Financave, nëpërmjet degëve të thesarit, të pajisë me “Voucher” (kuponin e garancisë së pagesës së shërbimit) AIDA-n, aplikantin fitues të skemës dhe ofruesin e shërbimit, kundrejt kontratës së nënshkruar ndërmjet aplikantit fitues dhe ofruesit të shërbimit.

11. PAGESA për ofruesin e shërbimeve të realizohet nga vetë aplikanti fitues i Skemës, të cilit, me përfundimin e projektit, i bëhet rimbursimi i vlerës, kundrejt kuponit “Voucher”, nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë dhe kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues të shpenzimit.

12. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve e ofruesve të shërbimit përcaktohen në rregulloren e funksionimit të skemës “Voucher”, e cila miratohet me një urdhër të përbashkët nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ministri i Financave.

13. Për menaxhimin e skemës “Voucher” ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

14. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përfshihen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

15. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 716, datë 26.8.2015

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “LORENZO” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “DEPO NR. 1, DEPO NR. 2 DHE DEPO NR. 3, TË AGJENCISË SË REZERVAVE TË SHTETIT PLASË, KORÇË”, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës dhe shoqërisë “Lorenzo”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Depo nr. 1, Depo nr. 2 dhe Depo nr. 3, të Agjencisë së Rezervave të Shtetit Plasë, Korçë”, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, me sipërfaqe të përgjithshme 8 699 (tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², nga të cilat, sipas genplanit, sipërfaqe në objekt 2 200,92 (dy mijë e dyqind presje nëntëdhjetë e dy) m² dhe sipërfaqe funksionale 6 498,08 (gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë presje zero tetë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 205 lekë